



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**

---



**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**  
**14 Nr. 1066/16**  
**Dt. 08.12.2016**

**PLANI I PUNËS PËR VITIN FISKAL**  
**2017**

**VUSHTRRI / Dhjetor 2016**

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 70 dhe 82 të Statutit të Komunës, me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ( Ligji për Prokurim Publik në Kosovë ) si dhe vendimeve e konkluzioneve të kuvendit të komunës, Drejtoria Komunale për Prokurim më dt. 08.12.2016, Kryetarit të Komunës i prezanton :

## **PLANIN E PUNËS TË DREJTORISË KOMUNALE PËR PROKURIM PËR VITIN FISKAL 2017**

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë Planin e Punës për vitin fiskal 2017 e ka hartuar duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, i shpallur me dekretin Nr. DL-041-2015, datë 29.12.2015( në tekstin e mëtejme LPP-së), Rregulloret, aktet dhe vendimet tjera të aprovuara nga Agjencioni Qendror i Prokurimit ( në tekstin e mëtejme AQP-së), Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik( në tekstin e mëtejme KRRPP-së) si dhe vendimeve dhe akteve tjera të organeve komunale, Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë e Financa.

Me këtë Plan identifikohen në detaje të arsyeshme të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë planifikon t'i realizoi gjatë vitit fiskal 2017, për gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë.

Sipas nenit 8 paragrafi 1 të LPP-së jo më pak se 30 ditë kalendarike para fillimit të viti fiskal 2017, secili Autoritet Kontraktues duhet të përgatis Planifikimin Paraprak të Prokurimit, në të cilin do duhej të identifikoheshin në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që Autoriteti Kontraktues parasheh ti prokuroi gjatë viti fiskal në fjalë, ndërsa sipas nenit 8 paragrafi 2 të LPP-së Brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një viti fiskal, Autoriteti Kontraktues do të përgadisë dhe do të dorëzoj Agjencionit Qendrorë të Prokurimeve ( AQP-së ) një planifikim përfundimtarë me shkrim, i cili identifikon në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, punët dhe shërbimet që që Autoriteti Kontraktues parasheh ti prokuroi gjatë viti fiskal në fjalë.

Meqenëse Plani është ngushtë i lidhur me përgatitjen e buxhetit komunal për vitin fiskal 2017 si dhe me aktivitetin gjegjësisht planin e punës të drejtorisë , Plani në përgjithësi do duhej të jetë i harmonizuar dhe të korrespondoj me kufijtë e buxhetit të Autoritetit Kontraktues për vitin fiskal 2017, për të gjitha shtyllat e buxhetit, si vijon :

- Administratë
- Shëndetësi
- Arsim
- Zyra Lokale e Komuniteteve
- Njësia e Zjarrfikësve

Po ashtu, në pajtim me dispozitat e nenit 39 të LPP-së, Drejtoria Komunale për Prokurim do të përgadis dhe dërgoi për publikim në KRPP edhe Njoftimin Paraprak. Ky Njoftim publikohet kur një Autoritet Kontraktues ka për qëllim dhënie, gjatë periudhës së ardhëshme 12 mujore, të një ose më shumë kontratave të furnizimeve, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose së bashku, kanë një vlerë të parashikuar prej pesëqindmijë ( 500,000.00 € ).

Njoftimi Paraprak, në pajtim me dispozitat e nenit 39 paragrafi 2 të LPP-së duhet të përgatitet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, dhe Autoriteti Kontraktues do të siguroi se gjitha verzionet e gjuhëve të një njoftimi paraprak janë në pajtueshmëri me ligjin dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

Përmes këtij Njoftim, veç KRPP-së dhe AQP-së, informacione të sakta për synimet e aktiviteteve të prokurimit të Autoritetit Kontraktues, mundë të sigurojnë edhe Operatorët Ekonomik të interesuar.

Planifikimi përfundimtarë, si dokument i aprovuar nga organi kompetent i Autoritetit Kontraktues do duhej të ishte pjesë përbërëse e Planit të punës të Drejtorisë.

Në vazhdim po paraqesim në detaje të arësyeshme planifikimin preliminarë të prokurimeve të cilat Drejtoria Komunale për Prokurim Publik synon t'i realizoi gjatë viti fiskal 2017, sipas kategorive, punë, shërbime dhe furnizime, për t'i përmbushur kërkesat gjegjësisht planifikimet e gjitha shtyllave buxhetore – njësive shpenzuese, si vijon :

#### KONTRATAT PËR FURNIZIM

Nr.	Përshkrimi i furnizimeve	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e fillimit
1	Furnizim me materjal zyrtar	95.270,00 €	2017
2	Furnizimi me naft dhe derivate të naftës	145.317,00 €	2017
3	Furnizim me materiale të shtypura për zyre	7.000,00	2017
4	Furnizimi me orendi për zyre	14.214,00	2017
5	Furnizimi me pajisje tjera	10.096,00	2017
6	Furnizimi me paisje për zerim	10.000,00	2017
7	Furnizimi me veshmbathje	18.500,00	2017
8	Furnizimi me ushqim dhe pije	55.108,00	2017
9	Furnizimi me material higjenik	51.816,81	2017
10	Furnizimi me butan gazë	200,00	2017
11	Furnizimi me teknologji informative dhe pajisjetë teknologjisë informative	36.850,00	2017
12	Furnizimi me dru për ngrohje	74.500,00	2017
13	Furnizimi me thëngjill për ngrohje	47.100,00	2017
14	Furnizimi me aparate fotokopjuese	7.350,00	2017
15	Furnizimi me makin për larjen e enëve	3.000,00	2017
16	Furnizimi inventar për shkolla	49.500,00	2017
17	Furnizimi me inventar për objektin e ri të komunës	50.000,00	2017
18	Furnizimi me medikamente për QKMF-re	52.300,00	2017
19	Furnizimi me pajisje mjeksore	9.327,00	2017

20	Furnizim me inventar për QKMF	8.000,00	2017
21	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	15.000,00	2017
22	Furnizimi me automjetë për bartjen e pacientëve për hemodializë	36.000,00	2017
23	Furnizimi me gypa për kanalizim për ujrat e zeza	40.000,00	2017
24	Furnizimi dhe vendosja e kamerave në qytet	5.000,00	2017
25	Furnizimi me libra për bibliotekë	5.500,00	2017
26	Furnizimi me inventar për shtëpinë e komunitetit	5.000,00	2017
27	Furnizimi me paisje për matje gjeodezike	16.000,00	2017
28	Furnizimi me pajisje laboratorike për shkollat e mesme	25.600,00	2017
29	Furnizimi me makina për mbjelljen e misrit	20.000,00	2017
30	Furnizimi me pajisje për përkrahjen e bizneseve të reja	40.000,00	2017
31	Furnizimi me fidane mjedre, qershi, lajthi, ftua etj.)	50.000,00	2017
32	Furnizimi me makina për sillazh	30.000,00	2017
33	Furnizimi me makina për mbjellje të grurit	20.000,00	2017
	<b>Totali:</b>	<b>1.053.548,81</b>	

#### KONTRATAT PËR SHERBIME

Nr. Rendor i prokuri meve	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
1	Servisimi i teknologjisë informative	6.845,00	2017
2	Botimet e reklamave dhe konkurseve	8.900,00	2017
3	Shërbimet e internetit	3.970,00	2017
5	Shërbime hotelierer	31.902,00	2017

6	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	41.780,00	2017
7	Shërbime tjera kontraktuese të kohëpaskohëshme	618.838,00	2017
8	Mirëmbajtja e objekteve	19.298,19	2017
9	Shërbimet e udhtimit jashtë vendit	8.350,00	2017
10	Shërbimet Arsimore dhe trajnuese	15.079,00	2017
11	Shërbimet e ndryshme shëndetsore	7.000,00	2017
12	Regjistrimi dhe kontrolla teknike e automjeteve	16.700,00	2017
13	Hartimi i projekteve	71.200,00	2017
14	Pastrimi dhe larja e automjeteve	1.600,00	2017
15	Shërbimet intelektuale dhe këshilldhëse	1.800,00	2017
16	Shërbimet e udhtimit brenda vendit	2.739,00	2017
17	Mirëmbajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	18.282,00	2017
		<b>874.283,19 €</b>	

#### KONTRATAT PËR PUNË

Nr. Rendor i prokurimeve	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
1	Asfaltimi i rrugës "Ahmet Ademi" projekt 2 (dy vjeçar)	32.000,00	2017
2	Asfaltimi i rrugës "Rrustem Mehmeti"	5.000,00	2017
3	Asfaltimi i rrugëve Stanoc i Epërm, gracë	120.000,00	2017
4	Asfaltimi i rrugës "Epojeja e Galicës" në fshatin Galicë	11.000,00	2017
5	Asfaltimi i rrugës "Veli Osmani" në fshatin. Dolak	17.000,00	2017
6	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Bivolak projekt 2 ( dy vjeçar)	38.000,00	2017
7	Asfaltimi I rrugës "Rexhep Rzhana" në fshatin Sfaraçak	20.000,00	2017
8	Asfaltimi i rrugës "Emin Uka" në fshatin Banjskë	20.000,00	2017
9	Asfaltimi i rrugës "Rexhep Rrahmani" në fshatin Kollë	15.000,00	2017

10	Asfaltimi i rrugës "Paqja" në fshatin Maxhunaj	11.500,00	2017
11	Asfaltimi i rrugës "Jeton Tërstena" Segmenti i II	14.000,00	2017
12	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Beçuk projekt 2(dy vjeçar)	153.000,00	2017
13	Asfaltimi i rrugës Stanic i Poshtëm - Lum Madh -Prelluzhë	80.000,00	2017
14	Asfaltimi i rrugës "Qemajl Jashari" në fshatin Ashlan	6.750,00	2017
15	Asfaltimi i rrugës "Musa Surdulli" në fshatin Samadrexhë	22.500,00	2017
16	Asfaltimi i rrugës Lagja Islami në fshatin Taraxhë projekt 2 ( dy vjeçar)	20.400,00	2017
17	Asfaltimi i rrugës "Abedin Maxhuni" në fshatin Maxhunaj	24.000,00	2017
18	Asfaltimi i rrugës "Çlirimi" në fshatin Mihaliq projekt 2(dy vjeçar)	17.200,00	2017
19	Asfaltimi i rrugës "Martirë e Druarit" në fshatin Druar projekt 2 (dy vjeçar	35.500,00	2017
20	Asfaltimi i rrugës "Vëllezërit Veseli"	14.016,00	2017
21	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Zhilivodë projekt 2 (dy vjeçar)	57.000,00	2017
22	Asfaltimi i rrugës "Selmon Maloku" në fshatin Samadrexhë projekt 2 (dy vjeçar)	19.000,00	2017
23	Asfaltimi i rrugës "Mulliri i Shpëtimit" në fshatin Ashlan	5.000,00	2017
24	Asfaltimi i rrugës "Rizah Mehana" në fshatin Akrashticë projekt 2 (dy vjeçar)	20.600,00	2017
25	Asfaltimi i rrugës "Zylfije Krasniqi"	10.560,00	2017
26	Asfaltimi i rrugës "Hasna Tiku Shabani " në Vushtrri	19.520,00	2017
27	Asfaltimi i rrugës i rrugëve lokale në fshatrat Reznik lagjet Mustafa, Curri dhe Makiqi si dhe fshatin Shallec lagja projekt 2 (dy vjeçar))	65.000,00	2017
28	Asfaltimi i rrugës "Sefer Mehana" në fshatin Akrashticë projekt 2 (dy vjeçar)	29.000,00	2017
29	Asfaltimi i rrugës "Agim Drevinja"	9.000,00	2017
30	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatrat Bivolak, Stroc dhe Gllavotin	15.000,00	2017

31	Asfaltimi i rrugës "Hasan Bunjaku" në fshatin Nedakoc	14.000,00	2017
32	Bashkfinancim me Ministrinë e Transportit	100.000,00	2017
33	Asfaltimi i rrugës "Dëshmorët e Druarit" projekt 2 (dy vjeçar	32.300,00	2017
34	Asfaltimi i rrugës "Sekine Maxhuni"	73.600,00	2017
35	Asfaltimi i rrugës "Zenun Avdulli" në fshatin Duboc	18.500,00	2017
36	Asfaltimi i rrugës "Nazmi Ispahiu"	10.880,00	2017
37	Asfaltimi i rrugës "Shefqet Isa" në fshatin Dumnicë	11.000,00	2017
38	Asfaltimi i rrugës "Hysen Hajrizi" në fshatin Balincë projekt 2 (dy vjeçar)	53.000,00	2017
39	Ndërtimi i trotuarëve	25.000,00	2017
40	Ndërtimi i parqeve	56.000,00	2017
41	Ndërtimi i Urave	15.000,00	2017
42	Riasfaltimi i rrugës Vushtri - Sllatinë	20.000,00	2017
43	Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara	70.000,00	2017
44	Ndërtimi i kanalizimeve	265.612,00	2017
45	Ndriçimi publik	10.000,00	2017
46	Rrënimi i objektit të komunës dhe rregullimi i oborrit	40.000,00	2017
47	Rrugët e rendit të katërt	50.000,00	2017
48	Rregullimi i varrezave	15.000,00	2017
49	Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni	318.364,00	2017
50	Projektet në bashkfinancim me donator	150.000,00	2017
51	Ndërtimi i Serave	30.000,00	2017
52	Projektet me bashkfinancim me donator - bujqësi	40.000,00	2017
53	Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave	40.000,00	2017
54	Renovimi i QMF-së në Lum Madh	15.000,00	2017
55	Renovimi i Shtëpisë Rezidenciale	18.800,00	2017
56	Restaurimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit	10.000,00	2017
57	Rregullimi i kulmit të palestrës sportive	8.000,00	2017
58	Ngjyrosja e hapësirave publike	7.000,00	2017
59	Ndërtimi i lapidarëve	30.000,00	2017

60	Ndërtimi i qendresë së kulturës projekt 3 (tre vjeçar)	990.000,00	2017
61	Renovimi i objektit para komunës	0,00	2017
62	Ndërtimi i shesheve në qytet	90.000,00	2017
63	Ndërtimi i shkollave fillore	0,00	2017
64	Ndërtimi i fushave sportive	0,00	2017
65	Renovimi / merermetimi i shkollave	89.000,00	2017
66	Rregullimi i platove në shkollat fillore në Druar, Pantinë dhe Maxhunaj	55.000,00	2017
67	Ndërtimi i rrethojave në shkolla	14.500,00	2017
68	Ndërtimi i çerdhës së fëmijëve projekt 3 (tre vjeçar)	336.800,00	2017
69	Rehabilitimi i fushës sportive në fshatin Stroc	10.000,00	2017
70	Ndërtimi i shkollës "Bajram Curri" në fshatin Dumnicë projekt 2 (dy vjeçar)	200.000,00	2017
71	Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Pestovë	14.000,00	2017
		<b>4.272.902,00</b>	

Ashtu sikurse është rregulluar me LPP-n, asnjë informatë mbi aktivitetet e planifikuara të prokurimit të Autoritetit Kontraktues nuk duhen të bëhen publike apo t'i zbulohen dikujt para publikimit të njoftimeve standarde. Arsyeja për këtë është mbrojtja e parimit të trajtimit të barabartë, i cili në këtë moment donë të thotë se informatat mbi një aktivitet të veçantë të prokurimit do t'i zbulohet operatorëve ekonomik në të njëjtën kohë. Kjo nënkupton që planifikimet e prokurimit nuk mundë të publikohen, apo publiku të ketë qasje në to.

Me gjithë obligimin sikurse u theksua më lartë, Drejtoria për Prokurim siguron se të gjitha iniciativat e procedurave të aktivitetit të prokurimit do të zbatohen dhe kryhen sipas LPP-së, neni 33, 34, 35 dhe 36, kapitulli mbi Rregullat mbi reklamimin dhe transparencën, në afat të caktuar kohorë, duke siguruar konkurrencë të drejtë, shfrytëzim sa më të mirë të parave publike, efikasitet dhe ekonomizim në zbatimin e drejtë të procedurave të prokurimit, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik.

Një nga detyrat permanente të Drejtorisë do të jetë transparenca në zbatimin e gjitha procedurave sipas LPP-së, duke filluar nga:

- Proceduar e hapur dhe e kufizuar
- Procedura konkurruese me negociata
- Proceduar e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës
- Procedura Konkursi i projektimit
- Proceduar e kuotimit të çmimeve, dhe
- Procedura e prokurimit në vlera minimale.

Varësisht nga aplikimi i cilësdo nga këto procedura, në rastet kur kjo parashihet me Ligj, Drejtoria do të zbatoi dispozitat ligjore, konform LPP-së.

Secili process i prokurimit do të administrohet perms 8 hapave, si në vijim :



Hapi 1	Planifikimi i Prokurimit
Hapi 2	Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i Kontratës
Hapi 3	Përcaktimi i Vlerës së Prokurimit
Hapi 4	Përgatitja e Dosjes së Tenderit
Hapi 5	Publkimi
Hapi 6	Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve
Hapi 7	Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës
Hapi 8	Menaxhimi i Kontratës

Edhe gjatë viti fiskal 2017 detyrë parësore e Drejtorisë do të jetë ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore i gjitha kërkesave të njërive shpenzuese, si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellët me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxhetit, si dhe përgatitja e planifikimit preliminar për gjitha llojet e prokurimeve për vitin e ardhshëm fiskal 2018. Ky Plan, sikurse u theksua më lartë, duhet ti prezantohet- dërgohet AQP-së 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal.

Për iniciimin e aktivitetit të proceduarve të prokurimit, Drejtoria, në harmoni me dispozitat e LPP-së, pas çdo vendimi të aprovuar nga Komiteti për Politikë e Financa apo Kuvendi Komunal, do të zhvilloi procedurën, si vijon:

- Vlerësimi i nevojave dhe disponueshmëria e mjeteve nga Zyrtari Kryesorë Administrativ, sipas nenit 9 i LPP-së ;
- Llogaritja e vlerës( para llogaria) dhe klasifikimi i kontratës, sipas nenit 16, 17 dhe 18 të LPP-së ;
- Përcaktimi i procedurës së prokurimit sipas nenit 19 të LPP-së ;
- Përgatitja e dosjes së tenderit, sipas nenit 27 të LPP-së ;
- Dërgimi ,në KRPP dhe në mjetet e informimit, i njoftimit për kontratë sipas nenit 40 të LPP-së ;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderit sipas neni 58 dhe 59 të LPP-së ;
- Njoftimi me shkrim i KRPP-së dhe konkurruesve mbi rezultatet e vendosjes për përzgjedhje e operatorit Ekonomik ma të suksesshëm
- Ankesat eventuale dhe procedimi lidhur me të njëjtat
- Nënshkrimi dhe përkujdesja lidhur me zbatimin efektiv të kontratës sipas nenit 26 të LPP-së


Për të pasur një efikasitet sa më të lartë në zbatimin e detyrave të punës, Drejtoria për Prokurim në planin e vet të punës, edhe për vitin 2017, në pajtim dhe me dispozitat e nenit 25 të LPP-së, parasheh trajnimin dhe perfeksionimin e mëtejshëm të personelit, si trajnime të organizuara dhe të obliguara nga IKAP-i ( Instituti Kosovar i Administrimit Publik ) ashtu edhe trajnime për zbatimin e teknologjisë informative.

Për informimin e Juaj ju bëjmë me dije se që nga 1 janari i viti 2017, me vendim të KRPP-së, përdorimi i prokurimit elektronik bëhet i obligueshëm për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit local dhe ndërmarrjeve publike.

Drejtorja për prokurim, në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësive të saj që i ka në bazë të ligjit, udhëzimeve administrative nga KRPP-ja dhe akteve normative komunale do të përgatitë dhe prezantoi për shqyrtim pranë organeve kompetente, si atyre qendrore dhe atyre komunale, raporte mbi prokurimet për periudhën tre mujore, gjashtëmujore dhe përfundimtare-vjetore ,për gjitha shtyllat e buxhetit.

Gjithashtu, në fushën e vetë të përgjegjësisë, Drejtoria për Prokurim, personeli i sajë, do të marrë pjesë, do të kontribuoj dhe implementoi vendimet e Kuvendit Komunal dhe komisioneve të tij, Komitetit për Politikë e Financa, do ti raportoj rregullisht Kryetarit të Komunës për çështjet që janë nën përgjegjësinë e drejtorisë, duke i ofruar atij informatat dhe raportet e nevojshme lidhur me ecurinë e punës në drejtori dhe për procesin e vendimmarrjes.

Drejtoria komunale për prokurim Publik

Drejtori,  
  
Fadil Muzaqi